

Çka pas anëtarësimit të Kosovës në BERZH?

1. Hyrje

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është institucion financiar që mbështet projekte në shtetet e Evropës dhe ato të Azisë Qendrore. Marrëveshja për themelimin e BERZH-it është nënshkruar në Paris më 29 Maj 1990, ndërsa ka filluar të operojë më 15 Janar 1991. Në bazë të Nenit 1 të marrëveshjes për themelim, qëllimi i Bankës është që të kontribuoj në zhvillim dhe rindërtim, nxitë tranzicionin në ekonomi të tregut dhe promovojë sektorin privat në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore.¹ Synimi është që të promovohet një ekonomi funksionale e tregut, ku bizneset konkurrojnë me njëra tjetrën, ku inkurajohet inovacioni si dhe të hyrat reflektojnë rritje të punësimit dhe produktivitetit. Banka financohet nga 64 shtete nga mbarë bota përfshirë edhe dy institucione ndërqeveritare: Bashkimin Evropian dhe Bankën Evropiane për Investime. BERZH është investitori më i madh në regjion.

Me vendim të Bordit të Guvernatorëve të datës 16 nëntor 2012, Kosova është bërë anëtare e 66-të, pranuese e fondeve të BERZH-it. Vendimi ka hyrë në fuqi me datë 17 dhjetor 2012 dhe BERZH-i pritet ta ndihmojë si sektorin privat ashtu edhe atë publik në Kosovë.

Në këtë studim, Instituti GAP synon të analizojë fushat dhe projektet konkrete ku Kosova do të mund të përfitonte tashmë si anëtare e BERZH-it. Studimi është i orientuar drejt krahasimit të fushave/projekteve të financuara nga BERZH-i në shtetet anëtare të saj, dhe planeve për zhvillim ekonomik të Kosovës, të bazuar kryesisht në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2013-2015² dhe strategjive nga sektorë të ndryshëm të miratuar nga Qeveria e Kosovës. Instituti GAP vlerëson se Kosova duhet të hartojë një

¹ Me vendim të Bordit të Guvernatorëve të datës 30 Janar 2004, BERZH-i ka shtrirë investimet e saj edhe në Azi (Mongoli)

² Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015, 25 prill 2011. Burimi:

<http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/raportedhepublikime/kornizaafatmesmeeshpenzimeve.aspx>

strategji gjithëpërfshirëse ku energjia e ripërtërishme, transporti multimodal dhe bujqësia marrin një rol thelbësorë në zhvillim ekonomik, me çka Kosova do të rriste përfitimet nga anëtarësimi në BERZH. Kjo analizë e GAP synon të kontribuojë edhe në hartimin e Strategjisë së Partneritetit në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

2. Mënyrat dhe fushat e investimit të BERZH-it

BERZH-i financon projekte të bankave, industrive dhe bizneseve, qofshin ato sipërmarrje të reja apo kompani ekzistuese përmes mënyrave si më poshtë:

- a) në mënyre direkte përmes huadhënies dhe investimeve me ekuitet;
- b) në disa raste banka luan rolin e garantuesit të kredisë;
- c) përmes formave të tjera si financim të tregtisë;
- d) asistencë teknike; dhe
- e) dialogimin e politikave.

Në të shumtën e rasteve, investimet direkte sillen prej 5 deri në 230 milion euro,³ dhe nuk kalojnë më shumë se 60-70% të kostos totale të projektit, përkatësisht 33% kur investimi bëhet me ekuitet,⁴

Investimet e Bankës karakterizohen nga tri faza:

- 1) faza e injektimit të kapitalit;
- 2) faza e asistencës teknike si p.sh. sjellja e ekspertëve, dhe
- 3) dalja nga investimi pas një periudhe afatmesme 5-7 vjet, duke ofruar shitjen e aksioneve tek pronari apo ofertimi publik.

Para se të fillojë investimet në një shtet, BERZH-i harton një strategji e cila në bazë të ekspertëve të kësaj banke dhe në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian vlerëson fushat ku do të mund të kontribuonte me investime dhe ekspertizë në mënyrë që të ndihmohet në tranzicion të ekonomisë së lirë dhe integrim në BE. Duhet cekur se para se strategjia të finalizohet, në përputhje me politikën e informimit të BERZH-it, draft strategjia publikohet në ueb faqen zyrtare të bankës për 45 ditë kalendarike, periudhë në të cilën pranohen komentet publike të palëve të interesuara.

³ Për shkak që bizneset në Kosovë janë kryesisht ekonomi të vogla, BERZH financon projekte duke filluar nga shuma prej 1 milionë euro.

⁴ BERZH-i dhe International Finance Corporation janë të vetmit investitorë institucional me ekuitet në rajon.

Sa i përket shkallës së interesit të huadhënies, ajo dallon varësisht nga projekti dhe klienti. Në parim shkalla e interesit bazohet në çmimet e tregut siç është ajo e Euribor,⁵ dhe pastaj i shtohet diferenca e cila bazohet në rrezikun e investimit në shtetin dhe projektin e caktuar. Bizneset e çfarëdo madhësie kanë qasje në huadhënie dhe investime me ekuitet, ato që ndërmarrin investime kapitale por edhe për qëllime të përmirësimit të performancës së menaxhmentit dhe planifikimit të biznesit. Banka financon projektet të cilat nuk do të mund të gjenin fonde financiare me kushte të njëjta kreditore.

Për t'u kualifikuar një projekt për fondet e BERZH-it duhet të plotësohen disa kushte siç janë:

- të ndodhet në njërin nga shtetet ku operon BERZH-i,
- sponzorizuesi i projektit të kontribuojë me një shumë të konsiderueshme të kapitalit,
- të përfitojë ekonomia lokale dhe të zhvillohet sektori privat duke kontribuar në tranzicion të ekonomisë së tregut, si dhe
- të përmbushen standardet bankare dhe mjedisore.

Në bazë të tabelës së mëposhtme shohim se investimet totale të Bankës për gjatë 20 viteve të veprimit të saj janë rreth 71 miliardë euro, ku rreth 55,8 miliardë euro janë investim në sektorin privat, ndërsa 15,2 miliardë euro janë investime në sektorin publik.⁶ Huadhënia bankare mbetet investimi kryesorë, ku BERZH-i ka ndihmuar në forcimin e stabilitetit financiar duke investuar në banka dhe ofruar kredi për biznese dhe individë. Ndihma përfshinë format e reja të kreditimit të cilat përmbushin nevojat e ekonomisë, ristrukturimin e institucioneve financiare, zhvillimin e produkteve bankare si dhe hua të vogla për gratë në biznes.

Tab.1: Investimet e BERZH-it në bazë të sektorit (1991-2011)

Sektori	Shuma (€ ,000)
Huadhënie bankare	16,907,924
Transport	9,173,715
Prodhim dhe shërbime	7,817,948
Energji	6,664,555
Agrobiznes	6,155,506
Burime natyrore	4,290,221
Infrastrukturë komunale dhe mjedisore	4,163,012
Fonde kapitale	3,057,576

⁵ Euribor është shkalla e interesit e bazuar në kriteret e tregut dhe në të cilën shkallë Euro ofertohehet nga një prime - bankë tek tjetra përbrenda Unionit Monetar Evropian.

⁶ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 7 dhjetorë 2012. Burimi: <http://www.ebrd.com/downloads/research/annual/invest11.xls>

Kapital Bankar	3,037,401
Telekom, Informatikë dhe Media	2,953,414
Sigurim dhe Shërbime Financiare	2,866,742
Financim i Biznesit të Vogël	2,055,531
Pronë dhe Turizëm	1,953,764

BERZH-i gjithashtu përkrahë rritjen e kapaciteteve shtetërore dhe lokale në mënyrë që të ketë një ekonomi funksionale. Këto projekte përfshijnë rrjetet e transportit, gjenerimi dhe furnizimi me energji, uji, higjiena publike, si dhe projektet tjera urbane. Sikur në gjithë fushat tjera, BERZH-i gjithashtu përkrah rritjen e kapaciteteve menaxheriale të institucioneve të energjisë dhe infrastrukturës. Në bazë të tabelës së mëposhtme shohim se investimet në sektorin e energjisë se ripërtërishme, qofshin ato direkte apo indirekte, zënë një vend mjaft të rëndësishëm me rreth 18% të investimeve në këtë sektorë.

Tab. 2: Nën-ndarja sektoriale në sektorin e energjisë

Nën-ndarja sektoriale	Shuma e projekteve totale (€ ,000)
Distribucioni i Energjisë Elektrike	3,304,562
Prodhim të Energjisë Elektrike	12,816,177
Transmisioni i Energjisë Elektrike	3,178,816
Distribucioni i Gazit Natyral	1,330,825
Energji të ripërtërishme	4,558,281
Total	25,188,663

Një fushë tjetër me rëndësi është agrobiznesi ku investimet përfshijnë fusha nga prodhimi deri tek modernizimi i rrjetit të shpërndarjes dhe shitjes. Gjithë këto projekte kontribuojnë në mënyrë direkte në rritjen ekonomike si dhe në shumë raste në përmirësimin e standardeve mjedisore.

3. Investimet e BERZH-it në shtetet në rajon

Në bazë të statistikave të BERZH-it, sektori në të cilin është investuar më së shumti përgjatë viteve të prezencës së BERZH-it në shtetet në rajon mbetet transporti me 1,2 miliardë euro. Investimet kryesisht dominohen nga infrastruktura rrugore, megjithëse edhe format tjera si hekurudhat, aeroportet, zënë vend të rëndësishëm. Në sektorin e huadhënies bankare pjesa më e madhe e fondeve ka shkuar në mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe financim të tregtisë. Investimet në energji janë orientuar në rritje të efijencës dhe në investime të energjisë së ripërtërishme.

Tab. 3: Investimet e BERZH-it në shtetet e rajonit

Sektori/ Shteti	Shqipëria	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia	Investimet totale për sektor (€ ,000)
Transport	177,663	244,806	75,825	727,669	1,225,962
Huadhënie Bankare	22,677	227,296	27,310	528,771	806,056
Energji	171,526	189,356	35,000	220,694	616,576
Agrobiznes	10,549	33,565	8,329	380,149	432,592
Infrastrukturë komunale dhe mjedisore	14,600	54,043	27,350	252,021	348,013
Burime Natyrore	38,744	19,314		230,862	288,920
Prodhimtari dhe Shërbime	64,277	55,965	3,853	138,056	262,150
Kapital Bankar	37,938	25,787	3,324	154,473	221,522
Pronë dhe Turizëm	38,943	29,621	62,435	57,663	188,662
Telekom, Informatikë dhe Media	62,807	47,766	500	50,944	162,016
Financim i Biznesit të Vogël	5,462	14,085	8,220	94,736	122,503
Sigurime dhe Shërbime Financiare	8,305	3,058	31,250	41,250	83,863
Fonde kapitale	8,090	5,266		52,560	65,915
Total (€ ,000)	661,581	949,928	283,395	2,929,847	4,824,750

Sa i përket vitit 2011, BERZH-i ka investuar në **Maqedoni** rreth 220 milion euro, kryesisht në infrastrukturë dhe energji. Në sektorin e energjisë është investuar në energji të ripërtërishme, ku BERZH-i ka aprovuar një huadhënie prej 65 milion euro kompanisë publike të gjenerimit të energjisë "ELEM", për ndërtimin e hidrocentralit Boskov prej 70MW. Investimet tjera përfshijnë investimet në infrastrukturë me 49% që kryesisht përbën infrastrukturën komunale dhe përmirësim të ambientit ku energjia merr pjesë me 30%, investimet në korporata me 12% në sektorët si agrobiznes, prodhim, pronë, turizëm dhe telekomunikacion dhe pjesa tjetër e fondeve është investuar në institucione financiare me gjithsejtë 9%.

Edhe në **Shqipëri**, në vitin 2011 sektori kryesorë i investimit ishte infrastruktura dhe energjia me gjithsejtë 72% të investimeve. Më 2011 BERZH ka investuar 50 milion euro në përmirësimin e rrjetit shpërndarës të energjisë, në mënyrë që kur të përfundojë projekti në

vitin 2014 të zvogëlohen humbjet në rrjetë.⁷ BERZH gjithashtu ka investuar në ndërtimin e katër hidrocentraleve tjera me gjithsejt 9,2 milion euro.

Serbia është një ndër përfituesit më të mëdhenj nga investimet e BERZH-it. Vetëm në vitin 2011 ka përfituar rreth 526 milion euro për 28 projekte. Nga 187 milion euro të investuara në infrastrukturë dhe energji, përfshihet një huadhënie afatgjate për kompaninë “Energo” për ndërtimin e dy hidrocentraleve në jug të Serbisë. Janë aprovuar 57 milion euro për investim në Transportin Publik të Beogradit për riparimin dhe ndërtimin e hekurudhës së tramvajit. Në institucione financiare janë investuar 201 milion euro, mjete të cilat kryesisht shkojnë për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme private. Një pjesë tjetër prej 107 milion euro është investuar në agrobiznese.

Mali i Zi në vitin 2011 ka nënshkruar gjithsejtë 5 projekte me BERZH me vlerë 43 milion euro. Investimi kryesorë është bërë në projektin i cili zëvendëson thëngjillin më përdorimin e mbeturinave të drurit si mjet për ngrohjen e shtëpive në Plvjelja.

4. Plani i zhvillimit ekonomik të Kosovës në raport me investimet e BERZH-it

Në bazë të shembujve të lartpërmendur, shohim se investimet më të mëdha BERZH-i i ka bërë në infrastrukturë, sektorin financiarë, sektorin e energjisë ku vend të madh zënë përmirësimi i efijencës, energjia e pastër dhe e ripërtërishme, agrobiznesi si dhe përmirësimi i mjedisit.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve planifikon që të shpenzojë rreth 645 milionë euro, që njëkohësisht përbën orientimin kryesor të investimeve kapitale të Qeverisë së Kosovës. Një nga projektet atraktive që BERZH-i do të mund të investonte është ndërtimi i autostradës R6 (Prishtinë-Hani i Elezit). Mirëpo, kur jemi tek strategjia e transportit në bazë të kësaj kornize, Ministria e Infrastrukturës nuk përmend fare buxhetin për transportin multi-modal (hekurudhor-rrugor-ajror), duke anashkaluar kështu një formë tejet të rëndësishme dhe me potencial si formë efijente e transportit veçanërisht për bartjen e mallrave.

⁷ Së fundi (janar 2013), Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Shqipëri i ka anuluar licencën kompanisë CEZ.

Përderisa në draft buxhetin e vitit 2013⁸ Ministria e Infrastrukturës për vitin 2013 ka projekte kapitale për rrugë dhe autostrada me vlerë rreth 300 milionë euro, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik janë ndarë vetëm 2,8 milionë euro për projekte në hekurudha dhe lokomotiva, me çka tregon se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e ka prioritet këtë formë të transportit.

Derisa objektiv i BE-së për vitin 2020 është që 20% e energjisë në BE të vij nga burimet e energjisë së ripërtërishme, 97 % e prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë është i bazuar në linjit. Në bazë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2013-2015, në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik një ndër projektet kapitale dhe strategjike për zgjidhjen e problemit të furnizimit me energji është ndërtimi i Termocentralit “Kosova e Re”, që për 40 vitet operacionale të tij po ashtu planifikohet të furnizohet me mihjet e linjtit. Edhe pse në “Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2009-2018” përmenden një sërë hapash drejt përkrahjes së burimeve të pastra të energjisë, në kornizën e lartpërmendur përveç Hidrocentralit të Zhurit, Qeveria e Kosovës nuk përmend projekte konkrete të energjisë së ripërtërishme me të cilat do t’i plotësonte standardet evropiane dhe do të përkrahej nga BERZH-i. Andaj, BERZH-i duhet të nxit format alternative të energjisë, me qëllim që Kosova të përmbush objektivat e BE-së.

Siç dihet, Kosova ka humbje të mëdha të energjisë në shpërndarje si dhe humbje komerciale. Për shembull, në vitin 2011 humbjet e përgjithshme kanë qenë 1.786 GWh apo 38.15% e energjisë e futur në shpërndarje, ndërsa humbjet komerciale kanë qenë 1,000 GWh apo 21.37% e konsumit.⁹ Projekti i përmirësimit të rrjetit të shpërndarjes dhe zvogëlimi i humbjeve komerciale do të ishte një nga projektet me të cilat Kosova do të mund të aplikonte në BERZH dhe të mbahej në pronësi publike rrjeti i energjisë.

Në bazë të raportit të Bankës Qendrore të Kosovës për Stabilitetin Financiar (2011),¹⁰ norma mesatare e interesit për gjysmën e parë të vitit 2011 ishte 14.3%. Këto norma të larta interesi nuk përkrahin zhvillimin ekonomik, për më tepër struktura e kredive mbetet e

⁸ Draft Buxheti 2013, Ministria e Financave, 8 dhjetorë 2010, <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/draftbuxheti2013.aspx>

⁹ Raporti Vjetor 2011, Zyra e Rregullatorit për Energji, http://ero-ks.org/Annual%20Report/Annual%20Report%202011/Raporti_Vjetor_2011.pdf

¹⁰ Raporti i Stabilitetit Financiar, Numër 2, Banka Qendrore e Kosovës, dhjetorë 2011 <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2011/Raporti%20i%20Stabilitetit%20Financiar%20Nr.%2002.pdf>

orientuar në sektorin e tregtisë me 52.5% të gjithsejtë kredive të lëshuara për ndërmarrjet. Një ndër sektorët e rëndësishëm të ekonomisë siç është bujqësia, vazhdon të ketë nivel tejet të ulët të pranimit të kredisë nga sistemi bankar, me vetëm 3.5% të gjithsejtë kredive të lëshuara. Kreditë nga sektori i bujqësisë dekurajohen me norma edhe më të larta interesi, ku mesatarja e shkallës së interesit për ndërmarrje sillet rreth 15.6%. Orientimi i lartë i BERZH-it në përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që përmes ndërmjetësimit financiar të ofrojë kredi dhe instrumente financiare të cilat i përshtaten nevojave të ekonomisë, mund të jetë një promotor i fuqishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe ekonomisë në përgjithësi. Vetëm në vitin 2011, BERZH-i ka bërë investime të reja në banka mbi 2,9 miliardë euro, ndërsa portfolio e tanishme e investimeve bankare arrin në 9,4 miliardë euro ku pjesa më e madhe e tyre i dedikohet stimulimit të kreditit të ekonomisë reale. Ndërsa, qoftë përmes investimeve financiare apo teknike, BERZH-i ka investuar rreth 945 milion euro në agrobiznes, duke mbetur kështu investitori më i madh në regjion në këtë sektorë.

Në bazë të vlerësimit të vitit 2007, pas Serbisë, Kosova si vend ka përqindjen më të lartë në rajon të tokës agri-kulturore (52%) dhe të lëvrueshme (27%).¹¹ Duke pasur parasyshë prioritetin e lartë të investimeve të BERZH-it në këtë sektor, dhe njëkohësisht potencialin e Kosovës sa i përket tokës bujqësore, agrobiznesi do duhej të ishte njëra nga fushat ku Kosova do mund të thithte investime direkte të BERZH-it. Si rezultat, këto investime do të sillnin uljen e importit, rritjen e punësimit, uljen e varfërisë si dhe uljen e dallimeve në të ardhura në mes zonave urbane dhe rurale. Sipas politikave të Bashkimit Evropian, Kosova nuk pritët të ketë edhe aq shumë subvencione, por të sigurojë infrastrukturë dhe kushte të nevojshme për konkurrencë të tregut. Kur jemi te kushtet e të bërit biznes, me gjithë përmirësimin në rangim në Raportin e Bankës Botërore mbi të bërit biznes,¹² Kosova mbetet e 98-ta në listë nga gjithsej 185 vende. Gjithashtu, duhet cekur se me gjithë rritjen e buxhetit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, buxheti i kësaj Ministrie për vitin 2013 përbën vetëm 2% të buxhetit qendror, gjersa agrobiznesi si fushë e investimit të BERZH-it në shtetet në rajon përbën diku rreth 35 % të investimeve. Ndërsa për vitin 2013 në bazë të Buxhetit të Kosovës 2013 për projekte kapitale në këtë ministri janë ndarë vetëm 8,8 milionë euro.

¹¹ Banka Botërore, 17 dhjetorë 2012, Burimi:

<http://databank.worldbank.org/Data/Home.aspx>

¹² Banka Botërore, 18 dhjetorë 2012, <http://www.doingbusiness.org/rankings>

E ranguar në publikimin e Transparency International si vend me perceptim të lartë korrupsioni sa i përket institucioneve publike,¹³ Kosova do të mund të përfitonte nga asistenca teknike në fushat siç janë prokurimi dhe transparenca. Banka gjithashtu ofron këshilla në dialogimin e formave të financimit përmes partneritetit publiko-privat si dhe dialogimin e politikave.

Me gjithë kualitetin e dobët të mjedisit në Kosovë, sidomos sa i përket cilësisë së ujërave, menaxhimit të mbeturinave, ndotjes së ajrit dhe tokës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në draft buxhetin e vitit 2013 ka ndarë vetëm gjysmë milion euro për projekte kapitale për mjedisin, ku përveç disa fushatave vetëdijësuese, gjelbërimit dhe rehabilitimit, nuk ka asnjë projekt konkret që do të qonte në përmirësim të kësaj situate. MMPH do duhej të hartonte një plan konkret se si t'i qaset BERZH-it dhe t'i shfrytëzojë mundësitë e financimit.

¹³ Transparency International, 7 dhjetorë 2012, <http://cpi.transparency.org/cpi2012/results/>

5. Përfundimet dhe rekomandimet

Gjersa Kosova u bë anëtar i 66-të në BERZH si shtet pranues i fondeve me datë 17 dhjetor 2012, kjo Bankë mbetet investitori më i madh në regjion me rreth 71 miliardë euro të investuara deri më tani. Qëllimi i Bankës mbetet funksionalizimi i tregut duke bërë investimet më të mëdha në sektorin privat dhe në fusha si transporti, energjia, agrobiznesi. Në anën tjetër, Kosova mbetet në një pozitë të vështirë për të bërë biznes, ku ka mungesë të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik. Duke filluar nga normat e larta të interesit, niveli i lartë i korrupsionit, mungesa e vizionit për krijimin e një strategjie në krijimin e burimeve për energji të ripërtërishme, orientimi i investimeve në infrastrukturë rrugore dhe lënia anash e investimeve në hekurudha tregojnë një ambient jo premtues për rritje ekonomike.

Në bazë të të gjeturave të këtij studimi, Instituti GAP rekomandon që:

- Kosova si shtet të orientohet në hartimin e një strategjie të zhvillimit ekonomik e cila është në përputhje me objektivat dhe standardet e BERZH-it.
- Në fushën e energjisë të hartojë një strategji ku përveç rritjes së eficiencës në këtë sektor, të përfshihen projekte dhe politika mbështetëse për ndërtimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë.
- Sa i përket transportit, potencial i investimeve të Bankës mbetet infrastruktura rrugore, prandaj përfshirja e hekurudhave si mjet eficient për transport duhet të ishte një ndër projektet kyçe që do të ndihmonte zhvillimin ekonomik.
- Bujqësisë duhet t'i jepet prioritet më i lartë, si njëri ndër sektorët me potencial për përfitim të fondeve dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës.
- Strategjia e zhvillimit ekonomik të Kosovës duhet të drejtohet drejt krijimit të kushteve dhe infrastrukturës për zhvillimin e sektorit privat si bartës kryesorë i zhvillimit ekonomik. Ndërkohë, duhen të hartohen politika që sigurojnë funksionimin e tregut siç janë: sigurimi i konkurrencës dhe respektimi i standardeve mjedisore.

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.